



+120
shtete



+1200
ekspertë



+20 komitete
teknike



Që nga
1909

**BASHKËPUNIM NDËRKOMBËTAR
NË FUSHËN E INFRASTRUKTURËS
DHE TRANSPORTIT RRUGOR**





FUSHAT QË MBULOJMË

TË GJITHA ÇËSHTJET QË LIDHEN ME TRANSPORTIN DHE INFRASTRUKTURËN RRUGORE

SIGURIA RRUGORE

PËRDORIME TË REJA NË RRUGË

POLITIKA E TRANSPORTIT

FINANCIMI

SIGURIA

PERFORMANCA E AUTORITETEVE
TË RRUGËVE

SHTRESAT
RRUGORE

OPERIMI I TUNELEVE

MJEDISI

AUTOMJETET E NDËRLIDHURA

MIRËMBAJTJA DHE STRATEGJITË OPERACIONALE

NDËRHYRJET NË RRJET

TRANSPORTI
I MALLRAVE

PARANDALIMI DHE MENAXHIMI
I FATKEQËSIVE

MIRËMBAJTJA
DIMËRORE

REZISTENCA
MJEDISORE

URAT

TRANSPORTI INTELIGJENT

RRUGË RURALE

PUNIMET E DHERAVE

MULTIMODALITETI

MENAXHIMI I ASETVE
RRUGORE

LËVIZSHMËRIA NË ZONAT
URBANE

...



Transporti rrugor janë mënyra më e vjetër e transportit dhe akoma mbi 80% e transportit në shumicën e vendeve kryhet nëpërmjet rrjeteve rrugore. Rrjetet rrugore duhet të përballojnë kërkesat e vazhdueshme për transport, tendencave të reja, presioneve shoqërore dhe efikasitetit të buxhetit.

Ekspertët, studiuesit dhe zbatuesit në të gjithë botën janë duke punuar në këto çështje me qëllim formulimin dhe zbatimin e veprimeve më efikase.

Bashkëpunimi ndërkombëtar është një mjet i fuqishëm në këtë proces.

- Në vend që të përpiqemi të gjejmë praktikën më të mirë, eksperiencat më të mira ndahen përmes takimeve dhe bashkëpunimit mes kolegëve, gjë që kursen kohë dhe para,
- Idetë gjithashtu mund të ballafaqohen, gjë që lehtëson zhvillimin e koncepteve të reja,
- Një bashkëpunim i tillë gjithashtu u mundëson pjesëmarrësve të promovojnë praktikat kombëtare.

PIARC, Shoqata Botërore e Rrugëve, u themelua në vitin **1909** për të lehtësuar këtë lloj bashkëpunimi për të gjitha çështjet që lidhen me transportin dhe infrastrukturën rrugore. Shoqata jonë ndërkombëtare është **apolitike dhe jo-fitimprurëse**. Ajo krijon rrjete të ekspertëve rrugor nga e gjithë bota, u siguron atyre metoda pune bashkëpunuese dhe boton rekomandimet dhe raportet e tyre. E gjithë kjo zhvillohet brenda kontekstit të transportit të integruar dhe të qëndrueshëm.

Produktet dhe **shërbimet** tona janë lehtësisht të arritshme dhe përqendrohen në pritshmëritë dhe kërkesat e shprehura nga anëtarësia jonë, e cila kryesisht përfshin qeveritë e mbi 120 vendeve.



MISIONI YNË

OFRIMI I NJË FORUMI CILËSOR NDËRKOMBËTAR PËR ANALIZIMIN DHE DISKUTIMIN E CËSHTJEVE LIDHUR ME INFRASTRUKTURËN DHE TRANSPORTIN RRUGOR

- Kongresi Botëror i Rrugëve, i cili është mbajtur çdo katër vjet që nga viti 1908
 - Abu Dhabi (Emiratet e Bashkuara Arabe) në vitin 2019;
 - Pragë (Republika Çeke) në 2023
- Kongresi Ndërkombëtar i Mirëmbajtjes Dimërore
 - Gdansk (Poloni) në 2018;
 - Calgary (Kanada) në 2022
- 1200 ekspertë ndërkombëtarë
- Mbi 20 Komitete Teknike dhe Task Force
- Takimet statutorë të Komitetit tonë Ekzekutiv dhe Këshillit
- Takime të nivelit kombëtar (Komitetet Kombëtare)



SHKËMBIMI I PRAKTIKAVE MË TË MIRA DHE OFRIMI AKSESIT NDAJ INFORMACIONIT BOTËROR

- Publikimi i raporteve, i disponueshëm falas - 1 në muaj
- Revista tremujore Rrugët në tre gjuhë (*Routes/Roads*)
- Konferenca – Karakteristikat e tuneleve, shtresave rrugore
- Përmbledhje të shkurtra (*Projekte speciale*)



AKTIVITETE NË NDIHMË TË VENDEVE NË ZHVILLIM

- Kërkesat e tyre përfshihen në tematikat tona të punës
- Seminare ndërkombëtare - një në gjashtë javë
- Grupe pune rajonale
- Mekanizma të ndihmës financiare



HARTIMI DHE PROMOVIMI I MJETEVE EFEKTIVE PËR TË NDIHMUAR NË VENDIM-MARRJET PËR INFRASTRUKTURËN DHE TRANSPORTIN RRUGOR

- Fjalori ynë për Infrastrukturën dhe transportin rrugor në shumë gjuhë
- HDM-4: politika e mirëmbajtjes së rrugëve dhe program (software) i analizës së investimeve
- DG-QRAM: një mjet për administrimin e transportit të mallrave të rrezikshme në tunele
- Manualet tematike në rrjet: siguria në rrugë, funksionimi i tuneleve, menaxhimi i aseteve rrugore, funksionimi i rrjetit / transporti inteligjent





SI FUNKSIONOJMË?



Komitetet Teknike dhe Task Forcat janë elementi më i dukshëm i PIARC.

Aty takohen mbi 1.200 ekspertë nga e gjithë bota, duke e bërë rrjetin e PIARC më **të madhin në botë të specialistëve të rrugëve**. Puna e tyre organizohet në rreth dy takime vjetore dhe seminare në vendet me të ardhura të ulëta ose të mesme, duke u mundësuar publikimin e raporteve për tematika teknike prioritare.

Pjesa më e madhe e botimeve tona janë në dispozicion në anglisht, frëngjisht dhe spanjisht - të cilat janë tre gjuhët e punës të PIARC - dhe ndonjëherë në gjuhë të tjera.



PARTNERITETE

PIARC krijon në mënyrë aktive partneritete me qëllim fuqizimin e rolit të rrugëve si një nga komponentët kryesor të sistemit të transportit, duke bërë të mundur që botimet tona të shpërndahen gjerësisht, duke kontribuar në shkëmbimin e praktikave më të mira, duke na siguruar një akses më të madh në komunitetin e ekspertëve rrugorë, duke koordinuar planet e veprimit dhe hartimin e projekteve të përbashkëta.

Komitetet Kombëtare të PIARC: shoqata kombëtare të rrugëve, të ngritura në nivel kombëtar në mbi 40 vende.

Shoqata rajonale të rrugëve: CEDR në Evropë, AGEPAR në Afrikën frëngjisht folëse, REAAA në Azi dhe DIRCAIBEA në Amerikën Latine.

Organizata zhvillimi që përfshijnë Bankën Botërore, Bankën Aziatike të Zhvillimit, Bankën e Zhvillimit të Amerikës Latine, etj.

Organizata teknike ndërkombëtare: TRB (Shtetet e Bashkuara), Shoqata Ndërkombëtare e Tuneleve dhe Nëntokës (ITA-AITES), FISITA, etj.



PSE TË ANËTARËSOHENI NË PIARC ?

MERRNI PJESE NË

- Aktivitetet tona
- Bashkëpunim në nivelin ndërkombëtar në çështjet që lidhen me rrugën
- Komitetet Teknike dhe Task Forcat
- Identifikimi i çështjeve që lidhen me rrugën

AKSESI

- Revista jonë *Routes/Roads*
- Biblioteka jonë online e botimeve
- Fjalori online i rrugëve
- Produktet tona software

Ne ofrojmë disa kategori anëtarësimi: qeveritë kombëtare; autoritetet rajonale; ndërmarrjet ose universitetet; anëtarësim individual.



EKIPI I PIARC

Këshilli

**Përgjegjësi
për administrimin
e Shoqatës**

Përbëhet nga delegacione nga vendet anëtare, secila e drejtuar nga një Delegat i Parë

Presidenti

**Zgjedhur
nga Këshilli**

Për një mandat
4-vjeçar

Komiteti Ekzekutiv

**Menaxhues
i Shoqatës**

Ndihmuar nga disa
Komisione

Sekretariati i Përgjithshëm i PIARC

**Koordinon
të gjitha
aktivitetet**

Me seli në Paris,
Francë

Drejtues dhe
ekspertë të siguar
nga disa vende
anëtare

Punonjësit

www.piarc.org

- Shkarkoni botimet tona



- Na ndiqni në mediat sociale



- Regjistrohuni në Buletin tonë



Përshtatur në shqip nga Nerejda Hoxha -
Sekretariati Përhershëm i Traktatit të Transportit

